



Nr. 7634/1 Prot
Sh. 26.12.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 803/1 prot.

Shkodër, më 20.12.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 86, datë 30.11.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutcionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, shkronja "n", të ligjit nr. 75, datë 04.11.2019 "Për Rininë", neni 7, shkronja "b", neni 10, pika 3, të VKM nr. 969, datë 02.12.2020 "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij", shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 86, datë 30.11.2023 "Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij"*


Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

VENDIM

Nr. 86 datë 30.11.2023

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ”

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 1 dhe 2 ; të Ligjit nr 75/2019 “Për Rininë” neni 10, pika 3; Manual udhezues operacional për Këshillat Vendor Rinor, me propozim të Kryetarit Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

VENDOSI

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR), dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria E Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Ervis SHIMAJ

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me 05.12.2023

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian CELEPIJA